

VENDIM
Nr. 61, datë 5.11.2025

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR BASHKIMIN ME
PËRTHITHJE TË BANKËS AMERIKANE TË INVESTIMEVE SHA ME
SUBJEKTIN FINANCIAR JOBANKË NOA SHA**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “e”, të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të shkronjës “k”, të pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar; dhe të pikës 7, të shtojcës nr. 1, të rregullores, “Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare”, miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a. (shoqëria përthithëse) me subjektin financiar jobankë NOA sh.a. (shoqëria e përthithur).

2. Banka Amerikane e Investimeve sh.a. (shoqëria përthithëse) duhet të njoftojë Bankën e Shqipërisë për përfundimin e procesit të bashkimit me përthithje.

3. Banka Amerikane e Investimeve sh.a. (shoqëria përthithëse) do të ushtrojë vetëm veprimtaritë bankare dhe financiare për të cilat është licencuar sipas aneksit të licencës së saj.

4. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

5. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gent Sejko